

1 E mërkurë, 24 shkurt 2021

2 [Konferencë për Ecurinë e Çështjes]

3 [Seancë e hapur]

4 [Të akuzuarit nuk janë të pranishëm]

5 --- Fillon në orën 11.00

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Mirëdita dhe mirë se erdhët të
7 gjithë brenda dhe jashtë sallës së gjyqit.

8 Znj. Sekretare, ju lutem deklaroni lëndën.

9 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] I nderuar z. Gjykatës, kjo
10 është lënda me numër KSC-BC-2020-07, Prokurori i Specializuar
11 kundër Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt.

12 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, znj. Sekretare.

13 Tani u lutem palëve që të prezantohen, duke filluar me Zyrën
14 e Prokurorit të Specializuar.

15 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Mirëdita, i nderuar zoti Gjykatës.

16 Përshtendes të gjithë këtu në sallë dhe jashtë saj. Këtu në emër të
17 Prokurorisë është Alex Whiting, Zëvendësprokuror i Specializuar;
18 James Pace, bashkëprokuror; Line Pedersen, menaxhere e Lëndës dhe
19 e Provave; mua më quajnë Valeria Bolici, Prokurore pranë ZPS-së.

20 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, znj. Prokurore.

21 I kaloj tani Mbrojtjes. Do të filloj me z. Rees që të
22 prezantohet.

23 Z. Rees, mikrofonin e keni të fikur.

24 Z. REES: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Mirëdita, z.
25 Gjykatës. Jam Jonathan Rees, përfaqësues për z. Gucati.

1 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Rees.

2 Z. Cadman, fjala është për ju.

3 Z. CADMAN: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Mirëdita, i
4 nderuar Gjykatës. Jam Toby Cadman, avokat për z. Haradinaj bashkë
5 me ndihmësin tim.

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Mirë, faleminderit.

7 Për procesverbalin, më quajnë Nicolas Guillou, Gjykatës i
8 Procedurës Paraprake për këtë lëndë.

9 Përpara se të fillojmë me rendin e ditës, u kujtoj dhe
10 njëherë palëve se nëse keni vështirësi teknike me videolidhjen, ju
11 lutem menjëherë të na informoni duke ngritur dorën. Nëse kemi
12 shkëputje të lidhjes, do të bëjmë çmos që të lidhemi menjëherë.
13 Nëse çështja nuk mund të zgjidhet dot menjëherë, mundet që ta
14 ndërpres seancën për disa minuta për të siguruar që linja të
15 rilidhet.

16 Më datë 17 shkurt kam planifikuar Konferencën e dytë për
17 Ecurinë e Çështjes për këtë lëndë. Qëllimi im sot është që të
18 shqyrtojmë ecurinë e çështjes dhe të organizojmë shkëmbimet midis
19 palëve për të siguruar një përgatitje të përsheptuar për gjykim.

20 Në veçanti dëshiroj që të diskutoj nxjerrjen e materialeve;
21 ecurinë e hetimeve të Prokurorit të Specializuar dhe planifikimin
22 për datën e depozitimit të dosjes paraprake; pikat juridike dhe
23 faktike për të cilat palët pajtohen; ecurinë e hetimeve të
24 Mbrojtjes; kalimin e parashikuar të dosjes së çështjes në
25 përputhje me rregullën 72(1) të Rregullores; kur mendojnë palët se

1 mund të jenë gati për gjykim; dhe për caktimin e datave të
2 mëtejshme në kalendar përpara kalimit të dosjes së çështjes.

3 Falënderoj ZPS-së dhe Mbrojtjen për parashtrimet me shkrim që
4 kanë bërë. Nuk është nevoja që t'i përsërisim këto parashtrime me
5 hollësi, por megjithatë u lutem palëve që t'u përgjigjen
6 parashtrimeve me shkrim të njëra-tjetrës në mënyrë koncize pas çdo
7 pike të rendit të ditës, të cilat do t'i marr një nga një.

8 I kujtoj dhe njëherë palët që të më njoftojnë paraprakisht
9 nëse ndonjë parashtrim ka nevojë për nxjerrje të informacionit
10 konfidencial në mënyrë që të kalojmë në seancë private apo të
11 mbyllur.

12 Përpara se të fillojmë, dëshiroj që të trajtoj një sërë
13 çështjes paraprake.

14 Së pari, dëshiroj të përmend kërkesën e parashtruar më datë
15 23 shkurt nga avokati i z. Haradinaj për ta zhvilluar këtë
16 Konferencë për Ecurinë e Çështjes në mungesë të klientit të tij,
17 sikurse edhe deklarohet në deklaratën që i është bashkëlidhur
18 kësaj kërkesë nga z. Haradinaj. Vë re se kjo është në përputhje me
19 rregullën 96(2)(c), kështu që e udhëzoj Mbrojtjen që njoftime të
20 tilla në të ardhmen t'i parashtrojë si letërkëmbim me
21 administratën e Gjykatës, duke bashkëlidhur dhe deklaratën
22 përkatëse.

23 Së dyti, përmend kërkesën e Mbrojtjes së z. Haradinaj për
24 nxjerrjen e informacioneve të caktuara sa i takon një komunikate
25 diplomatike. Do të jap një vendim me shkrim për këtë çështje,

1 prandaj dhe kjo temë nuk do të diskutohet sot në këtë Konferencë
2 për Ecurinë e Çështjes. Por nëse ndonjëra prej palëve dëshiron që
3 t'i përgjigjet parashtrimeve të Mbrojtjes së z. Haradinaj, u ftoj
4 që të bëni këto parashtrime me shkrim brenda datës 26 shkurt, që
5 është kjo e premtë.

6 Së treti, do të jap këto vendime gojarisht për riklasifikimin
7 e dokumenteve të protokolluara:

8 Në vijim të urdhrimit të datës 4 shkurt 2021 dhe të
9 parashtrimeve të ZPS-së të datës 19 shkurt 2021, jap këtë urdhër
10 për Administratoren: Të riklasifikojë si publik dokumentin me
11 numër F00051 të datës 19 tetor 2020; dhe në lidhje me këto
12 dokumente të mëposhtme që janë rreptësisht konfidenciale, të
13 riklasifikohen ato si konfidenciale dhe të hiqet shënimi *ex-parte*
14 për dokumentet me numër F00050 fraksion 01 dhe 02, të dyja të
15 datës 15 tetor 2020; të riklasifikohet si konfidencial edhe
16 dokumenti i protokolluar i Mbrojtjes Haradinaj i datës 15 tetor
17 2020; të riklasifikohet si konfidencial dhe t'i vihet në
18 dispozicion vetëm Mbrojtjes së z. Gucati, aneksi me numër 7 i
19 dokumentit F50 i datës 15 tetor 2020; të riklasifikohen si
20 konfidencial këto dokumente të protokolluara: F63, përfshirë të dy
21 shtojcat, të datës 30 tetor 2020; F74, i datës 11 dhjetor 2020;
22 shtojca 1 e dokumentit F75, e datës 14 dhjetor 2020; F85 me
23 shtojcën, i datës 18 dhjetor 2020.

24 Dëshiroj të përmend gjithashtu edhe këtë urdhër: I jap urdhër
25 Mbrojtjes së z. Gucati dhe Mbrojtjes së z. Haradinaj që të

1 depozitojnë brenda datës 26 shkurt 2021 versionet publike të
2 redaktuara, përkatësisht të dokumenteve F137 dhe F138.

3 Këto urdhra vlejné edhe për përkthimet ekzistuese për
4 dokumentet e protokolluara të lartpërmendura.

5 Dëshiroj që t'ju kujtoj edhe njëherë se më datë 19 shkurt
6 ZPS-ja ka nxjerrë dhe një dokument në bazë të rregullës 102(1)(b)
7 dhe ka depozituar dhe njoftimin në bazë të rregullës 102(3).

8 Më datë 12 shkurt (siç u përkthye) kam dhënë urdhër lidhur me
9 kërkesën e ZPS-së për mosnxjerrjen e kontakteve të disa
10 dëshmitarëve.

11 Dhe më datë 23 shkurt kam dhënë -- kam nxjerr një vendim
12 lidhur me nxjerrjen e paketave të dokumenteve që janë sekuestruar
13 nga Organizata e Veteranëve të Luftës.

14 Në fund, përpara se të fillojmë, kujtoj këtu edhe mocionet
15 paraprahe të depozituara nga z. Gucati dhe z. Haradinaj që janë
16 depozituar më datat 2 dhe 4 shkurt, për të cilat ende nuk është
17 marrë vendim.

18 Tani dëshiroj që të kalojmë te Prokuroria për ecurinë e
19 nxjerrjes së materialeve provuese. Në veçanti duam të dëgjojmë nga
20 Prokuroria lidhur me materialet e rregullës 102(1)(b). Dua të
21 përmend se kjo është depozituar, pra, ka përfunduar me anë të
22 paketës 7 më datë 19 shkurt dhe pritët që të përfundojë më datë 9
23 prill maksimumi.

24 Prandaj dëshiroj që t'i kërkoj Prokurorisë që t'u drejtohet
25 dy çështjeve të ngritura nga Mbrojtja: Dhjetë dëshmitarët e

1 përmendur në Konferencën e parë të Ecurisë së Çështjes, si edhe
2 mënyrën sesi do të bëhet kjo nxjerrje e materialeve.

3 Sa i takon rregullës 102(2), vë re se ZPS-ja nuk parashikon
4 aktualisht nxjerrje në bazë të kësaj rregulle. Sa i takon
5 rregullës 102(3), dua të përmend parashtrimet e ZPS-së se pas
6 njoftimit të depozituar më datë 19 shkurt, mund të ketë nxjerrje
7 të mëtejshme të materialeve shtesë në lidhje me palët e treta
8 brenda datës 9 prill.

9 Në lidhje me këtë, dua që të përmend se -- dua që t'i kërkoj
10 ZPS-së që të bëjë të ditur afatin që ka të bëjë me vendimin lidhur
11 me paketat e sekuestruara nga Organizata e Veteranëve të Luftës.
12 Gjithashtu, i kërkoj Mbrojtjes që të japë parashtrimet e veta
13 lidhur me fushëveprimin dhe njoftimin sipas rregullës 102(3), dhe
14 i ftoj palët që të angazhon në diskutime *inter partes* lidhur me
15 çështjet e nxjerrjes së materialeve në bazë të Vendimit Kornizë.
16 Në veçanti, dëshiroj që t'u përmend palëve që ky njoftim duhet t'i
17 komunikohet ZPS-së brenda datës 5 mars.

18 ZPS-ja duhet të më drejtohet me çdo mosmarrëveshje sa i takon
19 materialitetit të provave që parashikohen në Vendimin Kornizë.

20 Në lidhje me materialet e rregullës 103, dua të përmend
21 parashtrimet e ZPS-së në këtë aspekt, përfshi edhe faktin se mund
22 të nxirren materiale të mëtejshme në bazë të kësaj rregulle që
23 kanë të bëjnë me kërkesat e palëve të treta jo më vonë se data 9
24 prill.

25 Në lidhje me rregullën 107 dhe 108, përmend parashtrimet e

1 ZPS-së se mund të ketë kërkesa të mëtejshme në bazë të kësaj por
2 kjo nuk do të cenojë afatet orientuese.

3 Dua që t'i kërkoj Prokurorisë që të bëjë të ditur nëse
4 kërkesa të tilla mund të parashtrohen brenda datës 19 mars.

5 Në fund, apo më në përgjithësi, dëshiroj që të di nëse palët
6 po përballen apo parashikojnë që të përballen me vështirësi lidhur
7 me pjesën e mbetur të procesit të nxjerrjes së materialeve.

8 Znj. Prokurore, e keni ju fjalën.

9 Edhe njëherë ju kujtoj, nuk është nevoja që të përsërisni
10 gjithçka që keni parashtruar me shkrim. Përpiquni që të bëni një
11 përmbledhje dhe më shumë përqendrohuni te pyetjet apo çështjet e
12 ngritura nga Mbrojtja.

13 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës.

14 Duke filluar me detyrimet që ka Prokuroria për nxjerrjen e
15 materialeve në bazë të rregullës 102(1)(b), siç na e kujtoi edhe i
16 nderuari z. Gjykatës, Prokuroria i ka përmbushur të gjitha
17 detyrimet e veta në përputhje me këtë rregull.

18 Mbrojtja argumenton se ZPS-ja nuk e ka përfunduar këtë
19 nxjerrje, thjesht duke u mbështetur te fakti se ZPS-ja ka bërë të
20 ditur synimin e saj në Konferencën e parë të Ecurisë së Çështjes
21 për të bërë edhe intervista të tjera me dëshmitarë. Parashtrimet e
22 Mbrojtjes janë të pabazuara për këtë çështje.

23 Në lidhje me numrin e dëshmitarëve, ZPS-ja i ka përfshirë
24 këta në listën e dëshmitarëve. Pra, nuk ka asnjë detyrim për
25 Prokurorinë që të intervistojë të gjithë dëshmitarët të cilët

1 synon që të thërrasë për të dëshmuar në sallë të gjyqit.
2 Megjithatë, siç parashikohet në parashtrimet me shkrim të
3 Prokurorisë, Prokuroria synon që të thërrasë, të ftojë pra, për të
4 dëshmuar autorët e deklaratave të cilat i janë bërë të ditura
5 tashmë Mbrojtjes në përputhje me rregullën 102(1)(b) dhe/ose
6 rregullën 103 të Rregullores. Kjo u jep përgjigje të gjitha
7 dyshimeve të Mbrojtjes lidhur me këtë pikë.

8 Sa i takon parashtrimeve të Mbrojtjes lidhur me modalitetin e
9 nxjerrjes së materialeve në bazë të rregullës 102(1)(b), në
10 veçanti siç thotë avokati i z. Haradinaj, duhet që të theksoj se
11 këto parashtrime duket se nuk janë të bazuara sa ç'duhet.

12 Së pari, paketat e nxjerrjes së materialeve e përfshijnë një
13 indeks sa i takon numrave ERN, përshkrim të hollësishëm të çdo
14 artikulli të vendosur në dispozicion, kategorizimin e çdo zëri në
15 përputhje me kategoritë e rregullës 109(c), si edhe metadatat e
16 tjera të regjistruara në Legal Workflow.

17 Me kërkesë joformale të ekipit të Mbrojtjes së z. Haradinaj,
18 ZPS-ja i rikujton Mbrojtjes që Legal Workflow i jep mundësi çdo
19 përdoruesi që të gjenerojë në mënyrë automatike çdolloj indksi në
20 formën e tabelave Excel për çdo paketë të nxjerrje së materialeve.
21 Madje, ZPS-ja i kujton Mbrojtjes edhe hapat operativë për të
22 gjeneruar këtë indeks. Këto hapa s'janë asgjë tjetër veçse klikimi
23 i ikonës përkatëse në sistemin informatik Legal Workflow.

24 Për fat të keq, avokatët e Mbrojtjes duket se nuk e kanë bërë
25 dot një gjë të tillë. Vështirësia e Mbrojtjes duket se lind nga ky

1 problem, nga që ata nuk janë të familjarizuar siç duhet me
2 platformën elektronike që përdor kjo Gjykatë ku kanalizohet të
3 gjitha nxjerrjet e materialeve nga ZPS-ja siç parashikohet nga
4 Rregullorja.

5 ZPS-ja gjithashtu i ka sugjeruar avokatit mbrojtës të z.
6 Haradinaj që nëse kjo këshillë teknike e ZPS-së nuk është e
7 mjaftueshme, mund t'i drejtohet zyrën kompetente për asistencë për
8 të përfituar trajnim të mëtejshëm për sistemin Legal Workflow.

9 Së dyti, siç është parashtruar tashmë në Konferencën e
10 mëparshme për Ecurinë e Çështjes, dhe siç është parashtruar me
11 shkrim dhe më datë 1 shkurt të vitit 2021, të gjitha materialet e
12 nxjerra janë të kategorizuara në përputhje me kategoritë e
13 rregullës 109(c) sipas fushave të metadatave në Legal Workflow.
14 Edhe në këtë rast pretendimet e Mbrojtjes së z. Haradinaj se ky
15 kategorizim nuk është vënë në dispozicion, nuk është i bazuar.

16 Së treti, çdo argument i Mbrojtjes sa i takon momentit të
17 parashtrimeve, ose më saktë, të dorëzimit të tabelës sipas
18 rregullës 109(c), duket se rivendos në diskutim një çështje për të
19 cilën tashmë është marrë vendim nga Gjykatësi i Procedurës
20 Paraprake në vendimin e tij të datës 11 shkurt 2021. Këto
21 parashtrime duhen rrëzuar në bazë të faktit se Mbrojtja nuk ka
22 parashtruar argumente që e përlligjin rishqyrtimin e kësaj pike.
23 ZPS-ja nuk ka asgjë tjetër për të shtuar, përveçse të rikujtojë
24 edhe këtu parashtrimet me shkrim lidhur me këtë pikë.

25 Sa i takon pikës tjetër të rendit të ditës, rregullën 102(2),

1 nuk kam asgjë për t'i shtuar përmbledhjes të cilën ne ia kemi
2 dorëzuar Gjykatës. Unë dua të përmend këtu udhëzimet e bëra nga
3 Gjykatësi i Procedurës Paraprake në lidhje me parashtimet me
4 shkrim të Mbrojtjes që duket se kërkojnë nxjerrje të materialeve
5 jo të përfshira në listën e vënë në dispozicion nga ZPS-ja në
6 përputhje me rregullën 102(3). Unë kaq kisha për sa i takon
7 përgjigjeve lidhur me këtë pikë.

8 Në lidhje me rregullën 103, përveçse të rikujtoj edhe njëherë
9 këtu parashtimet me shkrim të ZPS-së, siç përmbledhen nga
10 Gjykatësi -- siç u përmbledhën nga Gjykatësi sot, dua që të them
11 vetëm dy gjëra.

12 Lidhur me vendimet e fundit për masat mbrojtëse, me
13 dokumentet e protokolluar, me dokumentin F136 në veçanti, Gjykata
14 i ka dhënë urdhër ZPS-së që t'i vendosë në dispozicion Mbrojtjes
15 një version të redaktuar të disa materialeve të caktuara që janë
16 objekt i nxjerrjes së materialeve. Këto materiale do të duhet të
17 kategorizohen në pajtim me rregullën 103 apo rregullën 102(1)(b),
18 ose madje edhe me një kategori në bazë të rregullës 102(3). Në
19 lidhje me këtë vendim, mund të jetë e nevojshme nxjerrja e
20 materialeve shtesë në bazë të këtyre tre kategorive.

21 Gjithashtu dëshiroj që të nënvizoj, siç është nënvizuar dhe
22 në parashtimet me shkrim të Prokurorisë, nëse do të ketë nevojë
23 për të shtuar diçka në bazë të këtyre kategorive, mundet që të
24 nxjerrim materiale në vijim të kërkesave të palëve të treta, siç e
25 kemi bërë të ditur tashmë, dhe materiale të tjera të cilat do të

1 dalin në rrjedhën normale të procedurës. Ne ende nuk parashikojmë
2 që kjo do të cenojë ecurinë e procedurës.

3 Për të qenë e qartë, ZPS-ja do të jetë në gjendje që të
4 depozitojë dosjen paraprake të lëndës dhe do të jetë e gatshme për
5 gjykim pavarësisht nga përmbushja e kërkesave të palëve të treta,
6 nëse do ta merrnin këtë brenda afateve të caktuara apo jo. Dhe ne,
7 gjithsesi, do të jemi në gjendje që ta depozitojmë dosjen
8 paraprake të çështjes pavarësisht nga ecuria e hetimeve të
9 ndërmjetme.

10 Një sqarim sa i takon rregullës 107 është i nevojshëm që të
11 bëhet duke pasur parasysh vendimet më të fundit të Gjykatës për
12 masat mbrojtëse. Në bazë të këtyre vendimeve, ZPS-ja nuk
13 parashikon më nevojën për të parashtruar kërkesa në përputhje me
14 rregullën 107.

15 Në veçanti, ka informacion sipas rregullës 107 me materialet
16 që do të nxirren në përputhje me vendimin e Gjykatës, që mban
17 numrin F136 të nxjerrë më datë -- të marrë më datë 22 shkurt.
18 Megjithatë, versionet e -- redaktimet e autorizuara i japin
19 zgjidhje të mjaftueshme kësaj çështjeje, çka do të thotë që nuk ka
20 nevojë për një miratim të mëtejshëm për të mundësuar nxjerrjen e
21 materialit.

22 Në mënyrë të ngjashme, në bazë të vendimit më të fundit të
23 Gjykatës të nxjerrë dje me numrin F141, që konfirmon se paketa 3
24 nuk është objekt i nxjerrjes së materialeve, do të thotë që nuk ka
25 nevojë më për miratim për nxjerrjen e materialit në bazë të

1 rregullës 107.

2 Kërkesat në bazë të rregullës 108 që duhen bërë brenda datës
3 19 mars 2021, do të varen ndër të tjera edhe nga materialet e
4 listës së ZPS-së në bazë të rregullës 102(3) që Mbrojtja do të
5 ketë dëshirë apo nevojë që të shikojë. Në veçanti, një prej
6 elementeve të listës, sipas rregullës 102(3), është një kopje e
7 artikujve të sekuestruar për të cilat është dhënë leja për masa
8 mbrojtëse dje. Kështu që është miratuar pra, dua të them, kjo
9 kërkesë, kështu që kjo miraton dhe nxjerrjen e materialit
10 Mbrojtjes nëse Mbrojtja e dëshiron e dëshiron këtë.

11 Unë mendoj se këto ishin të gjitha çështjet të cilat neve
12 donim që t'i miratonim në lidhje me nxjerrjen e materialeve.
13 Faleminderit shumë.

14 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

15 Tani i drejtohem Mbrojtjes. Z. Rees, urdhëroni.

16 Z. REES: [Përkthim][Përmes videolidhjes] I nderuar Gjykatës,
17 do të filloj në lidhje me dhjetë dëshmitarë që identifikoi ZPS-ja
18 në Konferencën e parë për Gjendjen.

19 Nuk është e qartë ZPS-ja lidhur me këtë pikë. A thotë ZPS-ja
20 që nuk do të thërrasin dëshmitarë në gjykim përveç atyre që kanë
21 bërë deklaratat dhe përmbledhjet e tyre?

22 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Në qoftë se jeni dakord z.
23 Rees, do t'ia jap fjalën Prokurores në mënyrë që ajo të përgjigjet
24 në pyetjen tuaj.

25 Z. REES: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Po, pajtohem.

1 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Për mendimin tim, nuk është ajo
2 që tha Prokurorja. Me sa e kuptova unë, nuk ka transkript të
3 dëshmimeve të këtyre dëshmitarëve, mirëpo Prokuroria ka ndërmend t'i
4 thërrasë për të dhënë dëshmi.

5 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Po, pikërisht ashtu, i nderuar
6 Gjykatës. Ka dëshmitarë që ZPS-ja ka ndërmend t'i thërrasë për të
7 dhënë dëshmi. Këta dëshmitarë nuk janë intervistuar, megjithatë
8 kanë bërë deklaratë që janë përfshirë në rregullën 102(1)(b), në
9 materialet sipas kësaj rregulle.

10 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

11 A u përgjigj Prokurorja në pyetjen tuaj z. Rees?

12 Z. REES: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Jo. Të vetmet
13 deklaratë që janë dhënë deri tani, janë ato nga punonjësit e ZPS-
14 së. Në këtë rast, pra, a ka ndërmend ZPS-ja të thërrasë dëshmitarë
15 të tjerë përveç atyre që janë d.m.th., vetë punonjësve të ZPS-së?

16 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Prokurorja.

17 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Këta vendim do ta marrë Prokurori, i
18 nderuar Gjykatës, dhe unë këtë e kam bërë të qartë dy herë deri
19 tani.

20 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

21 Z. Rees, vazhdoni.

22 Z. REES: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Unë mendoj që nuk
23 ishte kjo mënyra sesi parashikohej që Prokurorja t'i përqaset
24 kësaj Konferencë për Ecurinë e Çështjes. Unë mendova që ZPS-ja
25 kishte ndërmend të intervistojë dëshmitarë të cilët p.sh., kanë

1 qenë të frikësuar apo janë frikësuar, dhe se do t'i thërriste këta
2 dëshmitarë për të dhënë dëshmi në gjykim.

3 Mirëpo nga ajo që tha znj. Bolici tani, me sa kuptoj unë,
4 ZPS-ja nuk ka ndërmend të thërrasë dëshmitarë të tillë.

5 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Urdhëroni, znj. Prokurore.

6 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Unë tashmë e kam sqaruar këtë pikë
7 dhe qëndrimin e ZPS-së. Dua vetëm të them se nën dritën e këtij
8 informacioni, Mbrojtja mund edhe njëherë t'i rishikojë afatet për
9 kryerjen e hetimeve të veta. Faleminderit.

10 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Tani do të kalojmë te një
11 pyetje tjetër z. Rees, lidhur me nxjerrjen e materialeve.

12 Z. REES: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Sigurisht që nuk do
13 ta rishqyrtoj tabelën e afateve që kam ndërmend.

14 Në kundërshtim të asaj që thotë Prokuroria, ata nuk kanë --
15 pra, Prokuroria nuk ka përmbushur detyrimet e saj të nxjerrjes së
16 materialeve. Pas vendimit tuaj të djeshëm, i nderuar Gjykatës,
17 materiale të tjera ka që duhet të dorëzohen në bazë të rregullës
18 102(1)(b), 102(3), dhe rregullës 103.

19 Në lidhje me rregullën 102(3) dhe njoftimin që na është
20 dhënë, ky njoftim faktikisht përcakton sipas Prokurorisë se cilat
21 materiale ndikojnë në çështjet dhe të cilat Prokuroria i ka. Tani,
22 nëse ky material më pas do t'i jepet apo do t'i vihet në
23 dispozicion Mbrojtjes, është pikërisht njoftimi që e sjell në
24 vëmendje të Mbrojtjen materialin e këtillë që ka ZPS-ja. Ky
25 material duhet t'i dorëzohet Mbrojtjes në mënyrë që ajo të mund të

1 vlerësojë natyrën e materialit.

2 Konteksti i kësaj çështjeje, të paktën sipas asaj që thotë
3 Prokuroria, është se bëhet fjalë për rreth 4.000 dokumente
4 për afërsisht, të një natyre, karakteri konfidencial që e kanë
5 prejardhjen nga Task Forca Speciale Hetimore dhe të cilat nuk janë
6 nxjerrë në mënyrën e duhur. Këto dokumente, në qoftë se ZPS-ja ka
7 të drejtë, në qoftë se ato janë nga vetë ZPS-ja, atëherë ZPS-ja e
8 ka detyrimin e dorëzimit të këtyre dokumenteve në qoftë se këto
9 dokumente janë autentike dhe konfidenciale.

10 Lista, sipas rregullës 102(3) që na është dhënë, është e
11 papërshtatshme. Aty janë përfshirë 13 dokumente vetëm. Përshkrimet
12 janë shumë të shkurta dhe nuk përshkruhet se çfarë përmbajnë ato
13 dokumente, lidhja e tyre me çështjen dhe në çfarë shkalle apo mase
14 mund ta ndihmojnë ato Mbrojtjen në përgatitjet e veta të çështjes.

15 Në lidhje me këtë pikë, me sa kam kuptuar unë, ju, i nderuar
16 Gjykatës, doni që këto çështje t'ia paraqesim ne ZPS-së deri më 5
17 mars në bazë të korrespondencës midis palëve. Dhe në qoftë se kjo
18 çështje nuk zgjidhet, atëherë ne duhet përsëri çështjen ta kthejmë
19 te ju, pra, t'ju drejtohem i juve si Gjykatës.

20 Ne padyshim që do t'i ndjekim këto udhëzime të Gjykatës. Po
21 dua të them se nuk pres asnjë gjë tjetër përveçse kjo çështje t'i
22 kthehet përsëri Gjykatës. Gjatë gjithë procesit ZPS-ja ka lënë të
23 kuptohet se nuk e ka marrë seriozisht detyrimin e nxjerrjes së
24 materialeve, sikurse edhe e ka demonstruar deri tani.

25 Ne në parashtrimet tona me shkrim, në paragrafët 6 dhe 7 kemi

1 paraqitur një listë të disa materialeve që duhet patjetër të
2 përfshihen në njoftimin sipas rregullës 102(3). Kjo është shumë e
3 qartë. Ky material duhet të jetë në pronësi të Prokurorisë dhe bie
4 brenda fushëveprimit të rregullës 102(3) sikurse zbatohet përmes
5 nenit 21(6) të Ligjit. Dhe nuk ka dyshim, aspak dyshim, në qoftë
6 se ky material më pas duhet t'i jepet Mbrojtjes për ta parë
7 plotësisht, qoftë në formë të redaktuar ose jo. Kjo është një prej
8 detyrimeve të Mbrojtjes.

9 Ne thjesht presim që do të ketë vonesa të tjera të tepruara
10 lidhur me këtë çështje. Ne presim që të shohim këto materiale që
11 duhet të dorëzohen në bazë të urdhrave të Gjykatës, urdhrit tuaj
12 të djeshëm, i nderuar Gjykatës, lidhur me dëshmitarët dhe në
13 lidhje me materialet që janë pjesë e paketave 1, 2, dhe 3. Ne nuk
14 mund të japim kurrfarë komentesh të tjera se çfarë hetimesh mund
15 të vijojnë, apo çfarë hetimesh do të duhen pas nxjerrjes së
16 materialit të këtillë.

17 ZPS-ja, në parashtrimet e veta gjatë Konferencës së dytë për
18 Ecurinë e Çështjes, thotë se do të ketë disa materiale shtesë
19 sipas rregullës 102(1)(b), rregullës 103, dhe materiale shtesë në
20 bazë të rregullës 102(3). Gjithashtu ZPS-ja bën të ditur se do të
21 ketë materiale të tjera për t'u nxjerrë në bazë të rregullës 107,
22 pra, materiale të rregullës 107.

23 Dhe përsëri, pa u ndihmuar fare nga parashtrimet me shkrim të
24 Prokurorisë lidhur me këtë Konferencë për Gjendjen, ne duhet t'i
25 shohim këto materiale njëherë përpara se të japim mendimin dhe

1 qëndrimin tonë sesi do të vazhdojmë më tej, meqenëse nuk e dimë
2 natyrën e këtyre materialeve.

3 Nuk jam i sigurt në këtë pikë, i nderuar Gjykatës, në qoftë
4 se doni që unë të them edhe ndonjë gjë më tepër lidhur me pikën e
5 nxjerrjes së materialeve.

6 Ne kemi thënë edhe me shkrim, dhe nga ajo që është thënë nga
7 ZPS-ja sot, vetëm që e konfirmon edhe më shumë qëndrimin tonë. Ne
8 jemi në fazën fillestare të procesit të nxjerrjes së materialeve.
9 Mungesa e një dialogu konstruktiv nga ana e Prokurorisë në lidhje
10 me çështjet që ngre Mbrojtja në lidhje me materialet që duhen
11 nxjerrë, mund të nxjerrin vetëm vështirësi të mëtejshme për
12 mendimin tonë. Dhe kjo vjen nga përqasja përçmuese e Prokurorisë.

13 Në qoftë se nuk mund t'ju ndihmoj edhe me ndonjë sqarim
14 tjetër, atëherë unë do ta përfundoj këtu.

15 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Rees.

16 Për sa i përket shkallës apo fushëveprimit të listës së
17 rregullës 102(3) dhe materialit që lidhet me këtë rregull, kjo
18 është e saktë. Dua që njëherë të bëhen bisedime midis palëve për
19 të parë në qoftë se Prokuroria mund ta plotësojë këtë listë, dhe
20 pastaj në bazë të rregullës 103 i takon Prokurorisë që t'i
21 drejtohet Gjykatësit në qoftë se nuk dëshiron të nxjerrë këtë
22 material.

23 Përpara se të vazhdojmë me pikën tjetër, a keni ju z. Cadman,
24 për të shtuar diçka lidhur me procesin e nxjerrjes së materialeve,
25 sepse e di që janë paraqitur disa probleme si nga ju ashtu edhe

1 nga z. Rees, por t'ju drejtohem edhe juve në qoftë se keni
2 probleme me përdorimin e sistemit elektronik të Gjykatës Legal
3 Workflow dhe përdorimin e këtij sistemi.

4 Z. REES: [Përkthim][Përmes videolidhjes] I nderuar Gjykatës,
5 mbështes parashtrimet e kolegut tim, mbrojtësit të z. Gucati.

6 Unë nuk e kam të qartë sepse në qoftë se është kaq e lehtë
7 Prokuroria nuk mund ta bëjë, përgatisë një listë të tillë dhe t'ia
8 japë atë Mbrojtjes.

9 Për nga ana ime, unë padyshim që nuk e kam të lehtë t'i
10 kontrolloj dhe t'i shikoj të gjitha nxjerrjet, ashtu si na jepen,
11 në mënyrën e duhur pa një indeks apo listë numrash të rregullt.

12 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

13 Z. Cadman.

14 Z. CADMAN: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Ju faleminderit, i
15 nderuar Gjykatës.

16 Në lidhje me pikat që u ngritën për materialet në bazë të
17 rregullës 102(1) dhe (b) nuk kam se çfarë të shtoj. Ky është
18 qëndrimi i përbashkët i të dy Mbrojtjeve në lidhje me këtë pikë
19 dhe këtë e kemi paraqitur edhe në parashtrimet tona me shkrim.

20 Më tej dua të shpreh shqetësimet e mia në lidhje me mungesën
21 e një dialogu konstruktiv dhe mënyrës shpërfillëse të Prokurorisë
22 që ajo që ka shfaqur deri tani. Dhe për mendimin tonë, nuk do të
23 ketë njëfarë dialogu konstruktiv përveçse nëse Prokuroria zgjedh
24 një mënyrë tjetër nga ajo që ka zgjedhur deri tani.

25 Për sa i përket sistemit Legal Workflow, mendoj që

1 vështirësia më e madhe është puna që ne nuk jemi në Hagë në këtë
2 moment. Kur je në Hagë është më e lehtë të kesh qasje në disa
3 aplikacione që përdor ky sistem. Disa dokumente p.sh., nga larg
4 nuk mund të printohen dhe nuk mund të hapen prej nesh.

5 Këto janë vështirësi që ne i hasim. Dhe në qoftë se ky sistem
6 që përdor Prokuroria përmes krijimit të listave në formatin Excel
7 vazhdon, atëherë Mbrojtjes do t'i duhet një trajnim për përdorimin
8 e këtij programi. Unë them që kjo është një vegël e dobishme
9 mirëpo, sidoqoftë nuk e zëvendëson detyrimin që ka Prokuroria ndaj
10 nesh.

11 Nuk dua të përsëris ato që tha z. Rees, dhe nuk dua të
12 përsëris atë që është thënë në parashtrimet me shkrim, por jam
13 paksa i habitur nga ajo që tha ZPS-ja tani se nuk ka ndërmend të
14 thërrasë dëshmitarë. Sidoqoftë i takon Prokurorisë të marrë vendim
15 në lidhje me këtë.

16 Për sa i përket dy urdhrave që keni nxjerrë ju, i nderuar
17 Gjykatës, të datës 22 dhe 23, duhet të shikohet se në çfarë mase i
18 ka përmbushur ato detyrime ZPS-ja dhe në çfarë mase është e
19 kënaqur Mbrojtja nga përmbushja e këtyre detyrimeve.

20 Për sa i përket pikës së fundit, ju i nderuar Gjykatës, në
21 fillim përmendët pjesën 6 të nxjerrjes së materialeve. E di që nuk
22 doni që të vazhdojmë të bëjmë parashtrime gojore në lidhje me atë
23 pikë përveç atyre që kemi bërë me shkrim, mirëpo, ndoshta do të
24 jetë e nevojshme që të bëjmë parashtrime të tjera me shkrim në
25 kohën që vjen për shkak të ecures së ngjarjeve.

1 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Ju faleminderit, z. Cadman.

2 Lidhur me Workflow, kemi vite që punojmë dhe është një
3 instrument i dobishëm. Unë e kuptoj plotësisht se mbase nuk do të
4 ishte mënyra më e lehtë, sidomos kur je larg.

5 Për këtë arsye i bëj thirrje Zyrës së Administratës dhe Zyrës
6 së Mbrojtjes, seksionit të teknologjisë dhe informacionit që t'ju
7 japin ndihmën e nevojshme qoftë në formën e telefonatave,
8 trajnimit online. Besoj që kjo do të ishte shumë mirë për
9 Mbrojtjen, sepse ideja e përdorimit të sistemit elektronik është
10 që palët të mos duhet të bëjnë gjithë këto lista, dhe kjo
11 zëvendësohet nga makina, aparati në këtë rast i cili nxjerr
12 listat, dhe është edhe më efikase.

13 Prandaj, z. Rees dhe z. Cadman, nëse jeni dakord, do t'i
14 kërkoj Zyrës së Administratës të lidhet me ju për çdo përmirësim
15 të nevojshëm, sepse mund të ketë probleme ndoshta dhe me lidhjen.
16 Është shumë e rëndësishme mendoj që të keni qasje të mirë, sepse
17 për ju kjo është kyç që të merrni çdo provë të lidhur me çështjen.

18 Z. CADMAN: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Nëse më lejoni,
19 dua të shtoj dhe diçka.

20 Një nga vështirësitë që ne kemi si Mbrojtje deri tani, dhe e
21 di që është një çështje që e ka ngritur Zyra e Administratës, dhe
22 kjo ka të bëjë me ne që të kemi mundësinë t'i dërgojmë dokumente
23 klientit tonë, sepse ndryshe nuk ka ndonjë proces për komunikim të
24 privilegjuar elektronik me objektin e paraburgimit.

25 Pra, kjo do të na ndihmonte ne në punën tonë për të ecur

1 përpara me hetimin dhe respektimin e afatit kohor duke marrë
2 udhëzime nga klientët tanë.

3 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit shumë.

4 Z. Rees, doni të shtoni diçka?

5 Z. REES: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Jam dakord që
6 instrumenti Legal Workflow është një instrument i dobishëm dhe të
7 ndihmon. Nuk kam dyshim për këtë gjë.

8 Por sugjeroj që gjithsesi do të na ndihmonte nëse ZPS-ja do
9 të përfshinte njerëz në përgatitjen e dokumenteve dhe të na
10 ofronte një indeks, një tregues të të gjithë materialeve që do të
11 bëjë të njohura, sepse kjo nuk është detyra jonë mendoj.

12 Sistemi në vetvete dhe vetë Zyra e Administratës nuk janë
13 përgjegjës për procedimin e kësaj çështjeje apo këtyre çështjeve,
14 këtë detyrë e ka ZPS-ja. Prandaj, nuk është shumë t'i kërkosh
15 kësaj të përgatisë një tregues që të jetë i tillë, i lehtë për t'u
16 përdorur. Lidhur me materialet që na ka bërë të njohura, ne mund
17 ta përdorim këtë tregues shumë kollaj për të gjetur dokumentet që
18 na interesojnë në Legal Workflow, në procesin pra, sistemin
19 ligjor. Kaq kërkojmë.

20 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Znj. Sekretare, po ju them të
21 lidheni me Zyrën e Administratës që t'i jepet ndihmë Mbrojtjes
22 gjatë ditëve të ardhshme, sidomos lidhur me ndonjë mundësi
23 përmirësimi për qasjes e tyre në Legal Workflow dhe për ndonjë
24 mundësi komunikimi të privilegjuar midis mbrojtësve dhe klientëve.

25 Është bërë njëfarë përmirësimi me sa di unë, lidhur me këtë

1 pikën e fundit në një çështje tjetër, dhe shpresoj që kjo do të
2 mund të bëhet edhe në këtë rast.

3 Znj. Prokurore, keni diçka për të thënë lidhur me këtë që tha
4 Mbrojtja? Shkurt, ju lutem.

5 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Shkurt. Dua të them për procesverbal
6 se ZPS-ja hedh poshtë me vendosmëri çdo akuzë të pabazuar të
7 përgjithshme nga Mbrojtja se ne kemi ndjekur që qasje përbuzëse
8 ndaj tyre lidhur me detyrimin tonë për të nxjerrë materiale.

9 ZPS-ja ka respektuar të gjitha detyrimet e saj sipas
10 rregullave përkatëse, sipas afateve të përcaktuara nga Gjyqtari i
11 Procedurës Paraprake në Vendimin Kuadër.

12 Nuk e kuptoj se çfarë qasje konstruktive kërkon Mbrojtja nga
13 ne, përtej asaj që ne si Prokurori nuk kemi marrë asnjë kërkesë
14 nga Mbrojtja lidhur me ndonjë nga hapat e ndërmarra gjatë
15 procedurës së nxjerrjes së materialeve.

16 Mbrojtja e z. Haradinaj kërkon që t'i japim një tregues që
17 tregon, që shpjegon pra, kohën lidhur me mundësinë e nxjerrjes së
18 materialeve që ka të bëjë me z. Haradinaj, sikurse mund të vlejë
19 për çdo përdorues të kësaj platforme.

20 Në qoftë se më lejoni, kam dhe diçka tjetër për të thënë.
21 Mbrojtja e z. Gucati, duket se e ka keqkuptuar parashtrimin tonë
22 sot lidhur me nxjerrjen e materialeve në bazë të rregullës
23 102(1) (b) dhe 103, 102(3), si dhe 107.

24 Mbrojtja pretendon se nuk e ka të qartë se çfarë artikujsh
25 apo pika të tjera shtesë do të nxjerrim. Ne e kemi bërë shumë të

1 qartë se çfarë artikujsh shtesë do të bëjmë të njohur, si me
2 shkrim dhe sot më përpara, duke përcaktuar burimet për këtë nevojë
3 shtesë. Përveç vendimit të kohëve të fundit të Gjykatësit të
4 Procedurës Paraprake dhe të Prokurorisë për të nxjerrë materiale
5 të redaktuara sipas kërkesës së ZPS-së, ne e kemi shpjeguar që ky
6 material duhet të kategorizohet. Ky është burimi i materialeve
7 shtesë që do të bëhet i njohur sipas secilës rregull.

8 Pra, nuk ka kërkesë tjetër që mund të bëhet sipas rregullës
9 107. Pra, të gjitha ato që tha Mbrojtja e z. Gucati janë bazuar në
10 një keqkuptim të plotë të parashtrimeve të Prokurorisë të bëra sot
11 dhe me shkrim.

12 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, znj. Prokurore.

13 Nëse nuk keni ndonjë kërkesë tjetër për t'u përgjigjur,
14 kalojmë te pika e dytë e programit të sotëm që ka të bëjë hetimet
15 e ZPS-së, parashtrimet e dosjes paragjyqësore, dhe përfundimin e
16 nxjerrjes së materialeve.

17 Marrë parasysh parashtrimin e ZPS-së që do të mund ta
18 dorëzojë dosjen paraprake dhe materialet e lidhura me të bashkë me
19 tabelat në bazë të rregullës 109(c), duke përfshirë çdo material
20 të nxjerrë në bazë të kërkesave të palës së tretë, deri më 9 prill
21 2021.

22 Konstatoj më tej në parashtrimet e ZPS-së se i vetmi hap i
23 mbetur hetimor ka të bëjë me kërkesat e palës së tretë. Në këtë
24 drejtim ftoj ZPS-në të na thonë nëse ka një datë të përafërt të
25 përfundimit lidhur me gjithë materialet provë.

1 Keni fjalën.

2 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Sikundër e përmblohdhët edhe ju, ZPS-
3 ja pret që të përfundojë të gjithë nxjerrjen e materialeve në
4 kohën e paraqitjes së dosjes paragjyqësore. Ne presim që të marrim
5 përgjigje ndaj kërkesave të palëve të treta. Kemi një afat, por
6 nëse këto përgjigje nuk merren, kjo nuk do të ndikojë në mundësinë
7 tonë për ta dorëzuar dosjen dhe për të qenë gati për gjyq më pas.

8 Dua të theksoj që, siç thamë në parashtrimet me shkrim, puna
9 hetimore është e tillë që ne do të vazhdojmë punën tonë në
10 bashkëpunim me provat e nxjerra. Provat do t'ia bëjmë të njohura
11 Mbrojtjes sikurse i paraqesim në Gjykatë në bazë të dispozitave
12 përkatëse. ZPS-ja nuk mendon që këto do të ndikojnë në ecurinë e
13 shpejtë të procesit. Faleminderit.

14 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, znj. Prokurore.

15 Tani i drejtohem Mbrojtjes për këtë temë.

16 Z. Rees, keni fjalën.

17 Z. REES: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Ajo që mund të shtoj
18 unë është të theksoj skepticizmin tonë se nxjerrja e materialit do
19 të përfundojë më 9 prill 2021.

20 Ne presim ndërkohë nxjerrjen e materialeve sipas rregullave
21 102(1) (b) dhe 103. Presim zgjidhjen e shqetësimeve që ngritëm
22 lidhur me rregullën 102(3), listës në bazë të rregullës kaq, e
23 cila në vetvete mund të çojë në probleme lidhur me nxjerrjen e
24 materialeve të tjera.

25 Ne dëgjua atë që tha ZPS-ja se do të dorëzojë dosjen

1 paragjyqësore më 9 prill, por jemi skeptikë për këtë, lidhur me
2 faktin që nxjerrja e materialeve do të përfundojë në atë datë për
3 arsytet që thashë. Vetëm mbasi të marrim materialet e mëtejshme që
4 i presim dhe të zgjidhet çështja e listës, vetëm atëherë -- në
5 bazë të rregullës 102(3), vetëm atëherë do të jemi në gjendje të
6 vlerësojmë nëse është bërë si duhet puna e nxjerrjes së
7 materialeve.

8 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

9 Z. Cadman.

10 Z. CADMAN: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Nuk kam asgjë për
11 të shtuar, i tha kolegu, z. Rees. Ne e kemi shprehur skepticizmin
12 tonë gjatë gjithë kohës dhe i përmbahemi atij qëndrimi.

13 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Cadman.

14 Do të vazhdojmë me temën tjetër në program që janë pikat e
15 pajtimit për çështje ligji dhe fakti.

16 Unë e di që palët nuk kanë hyrë ende në diskutim lidhur me
17 mundësinë për të parashtruar pika pajtimi lidhur me çështjet e
18 ligjit dhe të faktit. Gjithashtu konstatoj afatin e propozuar nga
19 ZPS-ja për të arritur marrëveshje, nëse mundet, për këto pika deri
20 më 26 mars. Çdo pikë ligji apo fakti për të cilën nuk ka pajtim
21 deri në kohën e përcaktuar, do të përcaktohen nga Paneli Gjykses.

22 Në këtë bazë, dua të dëgjoj nga palët nëse kanë arritur
23 ndonjë parashtrim -- do të arrijnë ndonjë parashtrim të përbashkët
24 dhe nëse arrijnë marrëveshje deri më 2 prill, afati më i fundit.

25 Gjithashtu dua të theksoj se nuk janë të detyruara palët të

1 pajtohen për çështje ligji dhe fakti.

2 Znj. Prokurore.

3 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Po, i nderuar.

4 Sikurse kemi shprehur në këtë parashtrim për këtë konferencë,
5 ZPS-ja do të paraqesë deri më 12 mars pikat e pajtimit me të. Dhe
6 presim që Mbrojtja pasi të na japë mendimin e saj, ne si ZPS do të
7 jemi në gjendje, siç thashë, që deri më 2 prill të bëjmë
8 parashtrimet tona të përbashkëta.

9 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

10 Z. Rees.

11 Z. REES: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Ne nuk do të mund të
12 respektojmë afatin kohor të propozuar. Do të kemi probleme me
13 nxjerrjen e materialeve siç është tani afati kohor i nxjerrjes së
14 tyre në qoftë se Prokuroria do t'i paraqesë më datën 9.

15 Nuk mund të hymë në diskutime lidhur me pikat e -- çështjet e
16 faktit dhe të ligjit pa na u dhënë të gjitha materialet. Ne kemi
17 vështirësitë tona, siç e dini, lidhur me përgatitjen. Çështje të
18 cilat i kemi shprehur me hollësi në parashtrimet tona me shkrim në
19 paragrafët 26 e më tej. Ju, i nderuar Gjykatës, i njihni
20 vështirësitë tona që kemi lidhur me personat që jetojnë në vende
21 që kanë probleme me koronavirusin.

22 Dhe ne nuk jemi në gjendje të parashikojmë nëse do të
23 respektojmë afatin lidhur me marrëveshje për ligjin dhe faktin që
24 u propozua. Pra, neve mendojmë që është jorealiste nga ana e ZPS-
25 së që parashikon këtë lloj afati.

1 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Cadman.

2 Z. CADMAN: [Përkthim][Përmes videolidhjes] I nderuar
3 Gjykatës, me keqardhje dua të them, siç mund ta shikoni nga
4 parashtrimet tona në paragrafin 30 e më tej, pra, nuk pajtohem dot
5 me Prokurorinë sepse kemi vështirësitë tona.

6 Ne nuk mund as të fillojmë madje përgatitjet e duhura pa na u
7 përfunduar procesi i nxjerrjes së materialeve. Kështu që
8 parashikojmë që fillimi i prillit do të ishte afati për ta bërë
9 këtë. Po për shkak të mungesës së dialogut konstruktiv, ne nuk
10 mund ta përfundojmë pra, këtë punë në datë -- raportin më datën 22
11 dhe 23. Siç janë punët aktualisht nuk e respektojmë dot këtë afat.

12 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

13 Znj. Prokurore, dëshironi të përgjigjeni.

14 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Shkurt, shumë shkurt.

15 Duket sikur Mbrojtja i ka keqkuptuar parashtrimet tona për
16 këtë çështje. Nxjerrja e materialeve është bërë siç kërkon
17 rregullorja dhe siç është udhëzuar nga Gjykatësi i Procedurës
18 Paragjyqësore. Ky është një fakt dhe nuk mund të bëhen vlerësime
19 të tjera.

20 Ne si ZPS e kemi theksuar qartë se cilat janë materialet
21 shumë të kufizuara që mund t'i nënshtrohen nxjerrjes, kur ne t'i
22 marrim këto materiale brenda afatit të përcaktuar nga Gjykata. Nuk
23 ka arsye që ta pengojë Mbrojtjen që të fillojë punën e saj për
24 këtë çështje, në bazë të themelit të saj bazuar në materialin e
25 gjerë, të plotë që i është bërë i njohur Mbrojtjes sipas afateve

1 përkatëse.

2 Përveç kësaj, dua gjithashtu të them se Mbrojtja nuk na ka
3 dhënë asnjë shembull ku ne nuk kemi mbajtur një qëndrim
4 konstruktiv. Prokuroria tashti është në gjendje të vërë në dukje
5 një shembull të një qëndrimi jokonstruktiv nga ana e Mbrojtjes.

6 Unë pranoj se të dy ekipet e Mbrojtjes mendojnë që nuk do të
7 jenë në gjendje të angazhohen lidhur me çështjen e ligjit dhe
8 faktit, që ne të pajtohemi për këto para dorëzimit të dosjes
9 paragjyqësore. Kjo bie ndesh me ecurinë e shpejtë të procedurës.
10 Nga palët kërkohet që të konsultohen lidhur me pika pajtimi për
11 çështje ligji dhe fakti, sepse përmes konsultimeve mund të
12 zbulojnë që këto pika mund të zbulohen -- mund të përcaktohen, që
13 nga ana e tyre do të ngushtojnë objektin e procesit duke përfshirë
14 edhe përgatitjen e çështjes.

15 Ne si Prokurori jemi gati të paraqesim, parashtrojmë pika
16 ligji dhe fakti në bazë të rregullave 95 dhe 156 dhe udhëzimeve të
17 Gjykatës, dhe në interes të shpejtësisë së zhvillimit të procesit.

18 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, znj. Prokurore.

19 Z. Rees, keni fjalën.

20 Z. REES: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Siç e shihni z.

21 Gjykatës, ky është një shembull perfekt i qasjes shpërfillëse të
22 Prokurorisë sa i takon detyrimeve të saj për zbulim të materialeve
23 për këtë çështje.

24 E kam ngritur edhe në Konferencën e parë për Ecurinë e
25 Çështjes faktin se janë dy probleme që kanë nevojë për vëmendje.

1 I kemi kërkuar ZPS-së që t'i kushtojë vëmendje identifikimit
2 të materialeve të cilat i ka në zotërim dhe të cilat kanë të bëjnë
3 me origjinën dhe prejardhjen e materialeve që përmbajnë paketat 1,
4 2, dhe 3, përfshirë dhe materialin që ka të bëjë me autorësinë,
5 kronologjinë e kujdestarisë së materialeve, si edhe materialet --
6 si edhe momentin që nga krijimi e deri te mbërritja në zyrat
7 qendrore të Organizatës së Veteranëve të Luftës.

8 Kjo qasje pra, përgjigjja, me fjalë të tjera, që kemi marrë
9 nga ZPS-ja është krejt shpërfillëse, siç e tregon edhe lista me 13
10 pika sipas rregullës 102(3).

11 Ne e kemi ngritur në Konferencën e parë për Ecurinë e
12 Çështjes edhe një problem tjetër që ka të bëjë me detyrimin që na
13 vendoset neve për t'i dhënë njoftim të hershëm ZPS-së që të
14 ndërkyçet me ne për të identifikuar materialet përkatëse. Ky
15 detyrim do të kërkonte nga ana jonë që të konstatojmë nëse vetë
16 ZPS-ja ka luajtur apo jo një rol në nxjerrjen e materialeve zyrove
17 qendrore të Organizatës së Veteranëve të Luftës, duke i kushtuar
18 sidomos vëmendje elementit të futjes në kurth, të cilin ne e kemi
19 cekur edhe me z. Pace në Konferencën e parë për Ecurinë e
20 Çështjes.

21 Vetë z. Gjykatës mund të gjykojë nëse qasja që ndjek ZPS-ja
22 është apo jo shpërfillëse, por ne ende nuk jemi ndërkyçur me ZPS-
23 së për çështjet e ngritura deri tani.

24 Dhe, siç e propozon znj. Bolici, pak më përpara e tha, është
25 që nxjerrja e materialeve ka përfunduar. Mirëpo kjo bie ndesh me

1 parashtrimet me shkrim që vetë ZPS-ja ka bërë për këtë seancë. Ata
2 kanë thënë në seancë se synojnë që ta përfundojnë nxjerrjen e
3 materialeve brenda datës 9 prill.

4 Ne nuk do të futemi në qorrsokak nga ZPS-ja në këtë
5 procedurë. Ne nuk duam ta bëjmë në mënyrë të nxituar gjithashtu
6 këtë proces gjyqësor. Ne do të kërkojmë, në përputhje me urdhrat
7 që do të japë z. Gjykatës, që të kemi korrespondencë *inter partes*
8 me ZPS-në përpara datës 5 mars.

9 Ne sigurisht jemi skeptikë nëse ZPS-ja do të na përgjigjet
10 apo jo. Shpresojmë shumë që të na përgjigjet. Dhe vërtet
11 shpresojmë që si pjesë e kësaj korrespondence *inter partes* do të
12 marrim njoftim të plotë sipas rregullës 102(3).

13 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Rees.

14 Dikush tjetër do t'i përgjigjet kësaj? Jo.

15 Z. Cadman.

16 Shkurt, ju lutem, dhe vetëm për çështjen e pikave juridike
17 dhe faktike për të cilat palët pajtohen, se pastaj do t'i
18 diskutojmë në pikat e tjera të rendit të ditës për të tjerat.

19 Z. CADMAN: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Shumë shkurt do të
20 flasë.

21 Unë do të doja të theksoja vetëm mbështetjen që -- pra,
22 mbështetjen për fjalën e z. Rees, lidhur me qëndrimin shpërfillës
23 dhe përbuzës me të cilin ne përballlemi. Qëndrimi që mban ZPS-ja,
24 me thënë të drejtën, është një qëndrim qesharak.

25 Padyshim që z. Gjykatës do të duhet që të japë vendime

1 procedurale për të gjitha këto çështje. Nxjerrja e materialeve nuk
2 ka përfunduar ende. Edhe siç e pranon edhe vetë ZPS-ja, d.m.th.,
3 atë më datë 9 prill.

4 Duhet që t'i kujtojmë ZPS-së të gjitha detyrimet që ajo ka
5 për këtë çështje. Nuk i takon ZPS-së që t'i tregojë Mbrojtjes se
6 çfarë duhet të bëjë, apo që ta fusë Mbrojtjen me detyrim në një
7 proces gjyqësor të përsheptuar.

8 ZPS-ja duhet që t'u qaset këtyre diskutimeve në mënyrë
9 konstruktive dhe të logjikshme.

10 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Cadman.

11 Z. Rees, shumë shkurt për çështjen që ka të bëjë me pikat
12 juridike dhe faktike për të cilat pajtohen palët.

13 Z. REES: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Dëshiroj të theksoj
14 se, natyrisht që ne e kuptojmë avantazhin për të gjitha palët që
15 të kemi një diskutim konstruktiv në momentin e duhur kur të ketë
16 përfunduar nxjerrja e materialeve dhe kur të kemi përfunduar dhe
17 hetimet nga të dyja palët, përfshirë këtu dhe hetimet e Mbrojtjes.
18 Pra, e kam fjalën për diskutimet që mund të bëjmë midis të dyja
19 palëve, nëse mund të arrijmë në një marrëveshje për pikat juridike
20 apo faktike. Por kjo do të ishte e rëndësishme për t'u përgatitur
21 për një gjyq që të jetë i drejtë dhe që të jetë efikas.

22 Ne dëshirojmë që kjo të ndodhë, por kjo duhet të ndodhë në
23 një moment kohor që i jep mundësi Mbrojtjes që të kryejë hetimet e
24 veta, që të ketë përfunduar plotësisht nxjerrja e materialeve në
25 mënyrë që Mbrojtja të jetë në dijeni të të gjitha këtyre. Dhe

1 vetëm atëherë, në këtë moment mund të bëhen diskutimet e duhura,
2 në mënyrë që Trupit Gjykues mund t'i jepen, me aq sa është e
3 mundur, pikat juridike dhe faktike për të cilat palët bien dakord.

4 Ne vetëm këtë kërkojmë, afate kohore të mira për këtë gjë.

5 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit shumë.

6 Desha që të shtoj edhe unë diçka lidhur me pikat juridike dhe
7 faktike për të cilat palët pajtohen.

8 Së pari, unë nuk mendoj se nxjerrja e plotë e materialeve
9 është e nevojshme për ta filluar këtë proces. Ju mund të bini
10 dakord për ato pika që janë të thjeshta, p.sh., datëlindja e të
11 pandehurit apo çështje të ngjashme. Pra, këto nuk kanë nevojë për
12 nxjerrje të plotë të materialeve. Këtë mund ta filloni ta bëni.

13 Së dyti, dëshiroj që të përmend se pavarësisht nga objekti i
14 listës së dokumenteve sipas rregullës 102(3), ka tashmë materiale
15 të cilat u janë vënë në dispozicion. Janë materialet sipas
16 rregullës 102(1)(a) që janë nxjerrë së bashku me aktakuzën. Ka
17 edhe disa materiale sipas rregullës 102(1)(b). Mund të ketë debat
18 për rregullën 102(3), por unë mendoj se Mbrojtja mund ta fillojë
19 këtë proces. A do të përfundojë plotësisht apo jo, kjo është
20 tjetër çështje. Por unë i ftoj palët që të fillojnë diskutimet
21 pra, me ZPS-së.

22 Unë e kuptoj që ka njëfarë tensioni midis këtyre palëve. Ky
23 është i dukshëm këtu në sallë të gjyqit. Unë mendoj se në
24 mirëbesim ju duhet të filloni të diskutoni me njëra-tjetrën si
25 palë për të parë nëse mund të arrini në marrëveshje *inter partes*

1 për materialet e rregullës 102(3). Po kështu të filloni të
2 ndërkyçeni në mirëbesim për pikat juridike dhe faktike të cilat ju
3 mund të pajtoheni, dhe pastaj mund të vazhdoni me materialet e
4 tjera të cilat ende nuk janë nxjerrë.

5 Sa i takon pikave juridike dhe faktike për të cilat palët
6 duhet të pajtohen, kjo është tërësisht në dorë të palëve. Nuk ju
7 detyron askush që të arrini marrëveshje. Nëse Mbrojtja nuk
8 dëshiron që të pajtohet për pika juridike apo faktike, është e
9 drejta e Mbrojtjes për ta bërë një gjë të tillë, apo për mos ta
10 bërë një gjë të tillë.

11 Bëhet fjalë për një instrument që u jepet palëve për të
12 arritur në marrëveshje ndërgjyqësie përpara gjykimit, por nuk
13 është detyrim.

14 Kaloj tani në pikën tjetër të rendit të ditës që janë hetimet
15 e Mbrojtjes.

16 Së pari, dëshiroj që të falënderoj ekipet e Mbrojtjes për
17 parashtrimet e tyre lidhur me këtë pikë. Dëshiroj që të vërej këtu
18 se asnjë ekip i Mbrojtjes nuk është në gjendje që të bëjë të ditur
19 nëse do të kërkojë masa unike hetimore apo që të japë njoftim për
20 alibi.

21 Në këtë pikë i kërkoj Mbrojtjes që të na japë një përditësim
22 lidhur me ecurinë e hetimeve, dhe afërsisht sa kohë do t'u duhet
23 për t'i finalizuar këto aktivitete hetimore.

24 Z. Rees, fjalën e keni ju.

25 Z. REES: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Z. Gjykatës, në

1 mënyrë të çiltër ne kemi deklaruar tashmë me hollësi sa i takon
2 hetimeve të Mbrojtjes.

3 Kemi marrë nja 3.000 faqe material që nga data 4 janar. Të
4 gjitha janë, d.m.th., nuk janë kategorizuar të gjitha pra. Ka edhe
5 100 orë material të regjistruar, video pra, pamje filmike, të
6 cilat ne na duhet tashmë që të fillojmë e t'i shikojmë. Pra, janë
7 shumë materiale që na është dashur t'i shikojmë që nga data 4
8 janar.

9 Në këto materiale jepen identitetet e shumë personave të
10 cilët kanë luajtur një rol të rëndësishëm në ngjarjet që mbulon
11 aktakuza. Dhe siç kemi thënë edhe në Konferencën e parë për
12 Ecurinë e Çështjes, do të na duhet që t'i hetojmë plotësisht këto
13 ngjarje dhe do të duhet të marrim në intervistë çdo person që janë
14 identifikuar se kanë luajtur një rol të rëndësishëm.

15 Kalimthi në parashtrim ne themi se kjo detyrë pra, e
16 identifikimit të personave që kanë luajtur një rol të rëndësishëm
17 në këto ngjarje, vështirësohet nga refuzimi që bën ZPS-ja për të
18 dhënë të dhënat e individëve të cilët ata i përmendin si "persona
19 të tjerë" apo "bashkëpunëtorë" apo "disa pjesë të caktuara të
20 medias" apo "disa anëtarë të caktuar të publikut" në aktakuzë. Do
21 të na duhet ne, pra, na bie barra neve që të identifikojmë këta
22 persona.

23 Të paktën he për he, edhe pse z. Gjykatës e ka thënë që në
24 fillim se të dhënat e këtyre personave mund të jepen ose jo në
25 pritje të vendimit që do të jepet lidhur me një mocion.

1 Ne sigurisht, siç e prisni edhe ju, kemi filluar që t'i
2 shikojmë e t'i lexojmë, t'i shqyrtojmë pra, këto 3.000 faqe dhe
3 100 orë regjistrim në video. Mirëpo ky material nuk na është bërë
4 i ditur që më datë 4 janar, po edhe më mbrapa.

5 Në të njëjtën kohë, si Britania e Madhe ashtu edhe Holanda
6 përballet me një rritje shumë të madhe të numrit të rasteve me
7 COVID. Në krahasim me gjashtëmuajorin e parë të vitit që shkoi, në
8 Britaninë e Madhe janë forcuar kufizimet. Kufizimet mbi lëvizjet
9 si brendapërbrenda Britanisë së Madhe por edhe, sigurisht,
10 udhëtimet ndërkombëtare janë kufizuar. Ne mendojmë se këto
11 kufizime do të vazhdojnë edhe njëfarë kohe.

12 Siç duket, 21 qershori parashikohet si një afat, por deri
13 atëherë nuk ka shumë gjasa që të ketë ndryshime mbi kufizimet mbi
14 udhëtimet jashtë vendit. Gjithashtu, dëshirojmë të përmendim këtu
15 edhe kufizimet në Kosovë. Aty, pra, në Kosovë ka një shtetrrrethim
16 i cili e vështirëson intervistimin e dëshmitarëve që ne
17 planifikojmë të intervistojmë.

18 Megjithatë, duhet që t'i vijojmë hetimet tona, dhe do t'i
19 vijojmë hetimet tona me shpejtësinë e pranueshme brendapërbrenda
20 kufizimeve që na vendosen për të ruajtur edhe jetën dhe shëndetin.

21 Siç kemi thënë në parashtrimet tona, aty parashikojmë një
22 afat realist. Këto afate i propozojmë duke marrë si të mirëqenë që
23 data 9 prill do të jetë data e propozuar nga Prokuroria për
24 parashtrimin e dosjes paraprake. Prej kësaj do të duhen edhe nja
25 katër muaj nga ZPS-ja për të përgatitur dosjen e vet paraprake të

1 çështjes. Kjo do të na japë mundësi që të përgjigjemi me
2 argumentet tona, sepse ne kemi ndërmend që të parashtrijmë, pra,
3 të depozitojmë një dosje paraprake të çështjes nga ana e
4 Mbrojtjes, për të cilën ne mendojmë se do të jetë me vlerë për
5 Trupin Gjykses. Pra, afati që ne propozojmë është më pak sesa
6 katër muaj pas konfirmimit pra, që i bëhet nga ZPS-ja datës për të
7 përgatitur dosjen e tyre paraprake.

8 Pra, ne kërkojmë një afat që na jep 20 korrikun 2021, si datë
9 për depozitim të dosjes paraprake të Mbrojtjes. Gjithmonë me
10 kusht që do të respektohet data 9 prill nga ZPS-ja.

11 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit zoti avokat.

12 Një pyetje të vogël. Shikoj që ju përmendët në transkript dhe
13 kufizimet aktuale për të udhëtuar, sikur ky kufizim është shtyrë
14 për 21 qershor. Mos e kishit fjalën për datën 21 mars?

15 Z. REES: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Jo. Siç e kuptoj unë
16 është që nuk ka ende një datë definitive për heqjen e kufizimeve
17 sa u takon udhëtimeve ndërkombëtare. Është propozuar në Britaninë
18 e Madhe data 21 qershor, kur do të fillojë një qasje më e lirshme
19 sa i takon kufizimeve për KOVIDIN.

20 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Rees.

21 Z. Cadman, fjala për ju.

22 Z. CADMAN: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Dëshiroj të
23 përmend se propozimi i bërë për një afat për Mbrojtjen është një
24 qëndrim i përbashkët midis të dyja ekipeve Mbrojtëse sa i takon
25 këtij afati.

1 Dua që të them se krahas kufizimeve të vendosura, ekziston
2 dhe vështirësia e madhe sa i takon fluturimeve, nuk ka fluturime
3 të disponueshme. Siç e dini edhe ju, ne kishim ndërmend të bënim
4 një udhëtim në Kosovë, por fluturimet na u anuluan 24 orë përpara
5 nisjes. Pra, kemi dhe anulim fluturimesh krahas kufizimeve të
6 vendosura mbi udhëtimet.

7 Pra, duhet të kemi parasysh që përtej këtyre kufizimeve do të
8 na duhet edhe që të hymë në karantinë kur të kthehemi në Britaninë
9 e Madhe. Pra, kjo dhe na e kufizon shumë aftësinë për të ecur
10 përpara me këtë çështje. Prandaj kjo duhet mbajtur parasysh nga i
11 nderuari z. Gjykatës në vendosjen e afateve.

12 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Cadman.

13 Znj. Prokurore, keni diçka për të thënë?

14 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Po. Sa i takon fjalëve që thotë
15 Mbrojtja për numrin e materialeve të nxjerra në bazë të rregullës
16 102(1)(b) që konsiderohet si një numër shumë i madh, pra, shumë i
17 vështirë për t'u menaxhuar, dua që të them se mbi 379 materiale
18 sipas rregullës 102(1)(b), 132 tashmë i janë nxjerrë Mbrojtjes në
19 përputhje me rregullën 102(1)(a), pra, si materiale që mbështesin
20 aktakuzën apo si materiale, si prova shfajësuese. Mbrojtja këto i
21 ka, i ka këto materiale pra, tashmë prej disa ditësh.

22 Pra, 79 prej këtyre materialeve audiovizive, 122 janë
23 transkripte të materialeve audiovizive si në gjuhën angleze ashtu
24 dhe në atë shqipe. Pjesa më e madhe e materialeve audiovizive kanë
25 të bëjnë me deklaratave që kanë mbajtur njeri prej të akuzuarve,

1 apo të dy të akuzuarit. Pra, këto janë shumë të njohura për vetë
2 të akuzuarit.

3 Pjesa tjetër e materialeve janë raportime, reportazhe dhe
4 artikuj të mediave dhe prova të cilat merren nga domeni publik.
5 Shumë prej këtyre janë artikuj në gjuhën shqipe dhe fotografi të
6 ekraneve nga materiale dhe burime të hapura. Dhe rreth një e dyta
7 e atyre që mbeten janë përkthim i këtyre materialeve.

8 Pra, 379 materiale nuk është aspak një numër i madh. Por po
9 të kemi parasysh që një pjesë shumë e madhe e këtyre materialeve
10 janë thjesht përkthime, atëherë numri i materialeve që i janë
11 vendosur në dispozicion Mbrojtjes në bazë të rregullës 102(1)(b),
12 është shumë më i vogël nga sa duket dhe është i menaxhueshëm
13 lehtësisht.

14 Dëshiroj që të theksoj më tej se nuk ka asnjë arsye përse të
15 mos kenë filluar hetimet, po të kemi parasysh në veçanti se
16 Mbrojtja ka qenë në dijeni të kësaj çështjeje që prej arrestimit
17 të të akuzuarve dhe që prej vendosjes në material të -- që prej
18 vënies në dispozicion të materialeve që mbështesin aktakuzën.

19 Dhe mbi të gjitha, objekti apo fushëveprimi i aktakuzës është
20 shumë i kufizuar. Identifikon tre ngjarje kryesore që përbën edhe
21 thelbin e kësaj çështjeje, dhe këto tre ngjarje janë të
22 regjistruara në material filmik.

23 Dua të kaloj te një çështje tjetër. Është e vërtetë që KOVIDI
24 është një shqetësim i rëndësishëm dhe duhet marrë shumë
25 seriozisht, dhe duhet që të mbrojmë shëndetin dhe jetën si të

1 personelit të Gjykatës, ashtu edhe të ekipit të Mbrojtjes, ashtu
2 dhe të akuzuarve.

3 Por në të njëjtën kohë, duke pasur parasysh atë se çfarë ka
4 qenë në gjendje që të realizojë ky institucion gjatë kësaj
5 pandemie, ne mendojmë se disa hapa mund të kryhen nga Mbrojtja. Në
6 këto rrethana specifike të kësaj çështje, ku pjesa më e madhe e
7 informacioneve që i ka dhënë ZPS-ja janë marrë nga burime të
8 hapura, të cilat Mbrojtja i ka pasur në dispozicion, me terma
9 shumë të thjeshtë mund t'i gjejnë në mbarë botën pa pasur nevojë
10 që të shkojnë në terren.

11 Në rrethanat specifike të kësaj çështje, ku aktakuza
12 pretendon se të akuzuarit kanë kryer krime përmes deklaratave apo
13 shfaqjeve të tyre në publik, atëherë përgatitje e Mbrojtjes nuk
14 mund të kufizohet edhe aq nga kjo pandemi.

15 Lidhur me këtë, afati i propozuar për parashtrimin e dosjes
16 paraprake të çështjes nga Mbrojtja duket se nuk përputhet me
17 nevojën për një zhvillim të përshpejtuar të procesit gjyqësor në
18 bazë të atyre që unë thashë.

19 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, znj. Prokurore.

20 A ka dikush prej Mbrojtjes që do të ndërhyjë?

21 Urdhëro, z. Rees.

22 Z. REES: [Përkthim][Përmes videolidhjes] ZPS-ja përgjigjet
23 duke thënë se Mbrojtjes nuk i duhet kohë për të bërë hetime në
24 këto çështje.

25 Po të jemi të qartë, ZPS-ja ka kërkuar shtatë muaj nga data e

1 arrestimeve për të dorëzuar dosjen paragjyqësore. Ne kërkojmë
2 shumë më pak, rreth tre muaj. Që prej fillimit e kemi bërë të
3 qartë se kemi ndërmend t'i hetojmë çështjet që lidhen me
4 autenticitetin dhe konfidencialitetin, sikurse pretendohet nga
5 Prokuroria, të materialeve në paketat 1, 2, dhe 3.

6 Ne e kemi bërë gjithashtu të qartë nga fillimi se kemi
7 ndërmend të hetojmë çështjen e rrethanave sesi ato tre paketa
8 materialesh erdhën në selinë e OVL UÇK-së. Në këtë moment ZPS-ja
9 nuk ka paraqitur prova në këtë kontekst, por ne dëshirojmë që ta
10 hetojmë këtë aspekt.

11 Dhe gjithashtu kemi ndërmend të flasim me dëshmitarë që kanë
12 qenë të pranishëm në të tre rastet që i përmendi znj. Bolici. Dhe
13 them që aktakuza nuk kufizohet vetëm në ato tre konferenca shtypi.
14 Aktakuza fillon duke përfshirë një periudhë gjashtëmuajore, gjatë
15 të cilës kanë ndodhur ngjarjet që pretendohen. Me sa e kemi
16 kuptuar ne aktakuzën, ngjarjet që përshkruan Prokuroria nuk
17 kufizohen vetëm në tre konferencat por edhe në ngjarjet e tjera që
18 kanë ndodhur rreth kohës së këtyre tre konferencave.

19 Ne kemi ndërmend të flasim edhe me dëshmitarë të tjerë të
20 cilën kanë qenë të pranishëm, që kanë luajtur rol në këto ngjarje,
21 dhe të marrim prova për sa i përket motivit dhe qëllimit që kanë
22 pasur ata.

23 Pra, ka shumë punë hetimore që duhet të bëhet dhe që ne e
24 kemi ndërmend ta bëjmë. Ne nuk kemi qenë në gjendje të fillojmë në
25 mënyrën e duhur punën hetimore për shkak të kufizimeve me të cilat

1 përballëmi si rezultat i koronavirusit. Ne nuk i kemi kapacitetet
2 dhe burimet të cilat disponon Prokuroria.

3 Prandaj, në këto rrethana ne kërkojmë afatet që i thamë, të
4 cilat janë për mendimin tonë të arsyeshme dhe kërkojmë prej jush
5 që t'i merrni parasysh këto parashtime.

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Rees.

7 Z. Cadman.

8 Z. CADMAN: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Të theksoj edhe
9 njëherë atë që tha Prokuroria se kjo çështje lidhet me tre ngjarje
10 kyçe. Nuk bëhet fjalë vetëm për materiale nga burime të hapura, të
11 cilat janë të disponueshme publikisht dhe që mund të merren
12 lehtësisht dhe që mund të hetohen lehtësisht.

13 Nga këto 379 materiale që na janë dorëzuar që përmend
14 Prokuroria, thuhet se 132 tashmë na janë dorëzuar. Ne duhet ta
15 kontrollojmë këtë punë. Do të na ndihmonte në qoftë se do të na
16 informonte nëse ka ndonjë paketë veçazi që do të na dorëzohet.

17 Për sa i përket incizimeve, transkriptimeve, përkthimeve, ne
18 duhet njëherë të verifikojmë në qoftë se përkthimet e atyre
19 transkripteve janë të sakta. Ne nuk mund të mbështetemi vetëm në
20 fjalën e Prokurorisë. Si me çdo gjuhë -- çdo gjuhë ka veçoritë e
21 veta, dialektet e veta, dhe ne thjesht nuk mund të pranojmë që ajo
22 që thuhet në transkript është faktikisht ajo që thuhet nga folësi.

23 Kështu që do t'i kërkoja Gjykatës -- do t'ju kërkoja Gjykatës
24 i nderuar që të merrni parasysh të gjitha këto kur të merrni
25 vendim rreth afateve.

1 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Ju faleminderit.

2 Tani, përpara se të kalojmë te pika tjetër, do t'u kthehem
3 përkthyesve t'i pyes në qoftë se mund të vazhdojmë për 10 edhe 15
4 minuta të tjera?

5 I falënderoj përkthyesit për fleksibilitetin e tyre që na
6 mundësuan të vazhdojmë të punojmë edhe 10, 15 minuta të tjera.

7 Tani do të kaloj në dy pikat e fundit të rendit të ditës,
8 është kalimi i çështjes Trupit Gjykues dhe kur palët do të jenë të
9 gatshme për të filluar gjykimin.

10 Së pari, marr parasysh parashtrimet e Mbrojtjes lidhur me
11 propozimin që çështja të gjykohet nga një Trup Gjykues i përbërë
12 prej një gjykatësi të vetëm.

13 Në këtë drejtim dua të rikujtoj Mbrojtjen se çdo vendim
14 lidhur me caktimin e një Paneli është kompetencë e Kryetares dhe
15 jo Gjykatësit të Procedurës Paraprake, në bazë të rregullës 72.

16 Në këtë drejtim gjithashtu theksoj se kalimi i çështjes
17 Trupit Gjykues nuk do të thotë që gjykimi do të fillojë në të
18 njëjtën moment me dorëzimin e dosjes së çështjes. Thjesht është
19 një përkujtim se është faza përfundimtare e përgatitjeve për
20 fillimin e gjykimit dhe se kjo fazë do të mbikëqyret nga Trupi
21 Gjykues.

22 Tani dua t'i dëgjoj palët lidhur me kalimin e çështjes Trupit
23 Gjykues rreth mesit të prillit 2021, në bazë të rregullës 72 të
24 Rregullores lidhur me procedurat e shpejtuara.

25 Urdhëro, znj. Prokurore.

1 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Për Prokurorinë nuk ka kurrfarë
2 problemi që dosja e çështjes t'i kalohet Trupit Gjykues në varësi
3 të zgjidhjes së çështjeve që kanë mbetur të hapura, dhe për ne,
4 siç thashë, nuk ka lidhje nëse kjo datë do të jetë mesi i prillit
5 apo edhe një datë e më hershme.

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Ju faleminderit, znj.
7 Prokurore, por nuk mund të jetë një datë më e hershme në goftë se
8 nuk e keni dorëzuar dosjen paragjyqësore.

9 Tani do t'i drejtohem Mbrojtjes.

10 Urdhëro, z. Rees.

11 Z. REES: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Pika fillestare e
12 nismës këtu është rregulla 95 -- më falni, e thashë gabim,
13 rregulla 98 e Rregullores që trajton çështjen e kalimit të dosjes
14 së çështjes Trupit Gjykues.

15 Rregulla 98(1) përcakton që e gjithë dosja e çështjes i
16 kalohet Gjykatësit të Procedurës Paraprake vetëm pasi që të jenë
17 marrë të gjitha parashtimet nga zyra e Prokurorit dhe Mbrojtja në
18 bazë të rregullës 95(4) dhe (5).

19 Rregulla 98 pra, thotë se dosja e çështjes nuk i kalohet, me
20 fjalë të tjera, Trupit Gjykues derisa të shkëmbehen dosjet
21 paragjyqësore midis palëve.

22 Rregulla 72(1) parashikon mundësinë e kalimit të dosjes së
23 çështjes në një mënyrë tjetër se ajo që parashikohet në rregullën
24 98, dhe përpara se palët të kenë shkëmbyer dosjet paragjyqësore.

25 Për këto qëllime, kur dosja e çështjes duhet t'i kalohet

1 Trupit Gjykses në përputhje me nenin 95(2) të Ligjit, nuk është
2 një rregull i përgjithshëm që të përshpejtohet dorëzimi i dosjes
3 së çështjes përpara shkëmbimit të dosjeve paragjyqësore midis
4 palëve. Një rast i tillë mund të ndodhë në përputhje me nenin
5 25(2) të Ligjit.

6 Neni 25(2) i Ligjit thotë:

7 "Lidhur me procedurat që lidhen me nenin 15 -- që dalin nga
8 neni 15(2), pra, për veprat penale të përshkruara në këtë nen --

9 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Nuk dëgjohe avokati qartë.
10 Është larguar nga mikrofoli.

11 Z. REES: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Neni 25(2) thotë:

12 "Në procedura lidhur me veprat penale nga neni 15(2) të cilat
13 nuk klasifikon si vepra penale të rënda në bazë të nenit 22 të
14 Kodit Penal -- të Kodit të Procedimit Penal të Kosovës, Ligji nr.
15 04\L-123, Trupi Gjykses mund në atë rast të përbëhet nga një
16 gjykatës i vetëm."

17 Për mendimin tim duhet të bëhet një vendim kryesor përpara se
18 të konsiderohet në qoftë se do të përdoret rregulla 72. Vendimi i
19 parë që duhet të bëhet është në qoftë se kjo çështje do të
20 gjykohe nga një Grup Gjykses i përbërë prej një gjykatësi të
21 vetëm sipas rregullës 25(2), apo nga një Grup Gjykses i plotë i
22 përbërë nga tre gjykatës të përhershëm dhe një rezervë në bazë të
23 rregullës 25(1)(b).

24 E di dhe e pranoj, i nderuar Gjykatës, atë që thatë ju se ju
25 nuk keni kompetencë të caktoni Grupin Gjykses në këtë çështje, dhe

1 se kjo kompetencë është e Kryetares.

2 Në këto rrethana, ne parashtrojmë se është ende herët për të
3 vendosur në qoftë se do të zbatohet rregulla 72. Vendimi i parë që
4 duhet marrë përpara këtij vendimi kryesor, pra, në qoftë se Trupi
5 Gjykues do të jetë prej një gjykatësi të vetëm i përbërë apo prej
6 tre gjykatësve.

7 Në këtë kontekst, gjithashtu theksojmë se në direktivën për
8 caktimin e gjykatësve thuhet qartë se këto çështje duhet të jenë
9 transparente. Është një vendim i vetvetishëm, nuk ndjek procedurat
10 në lidhje me veprat penale të nenit 15(2), nuk klasifikohet pra,
11 si vepër penale e rëndë sipas nenit 22 të Kodit të Procedimit
12 Penal të Kosovës. Ky siç thashë -- siç thatë edhe ju, kjo
13 kompetencë e caktimit të Trupit Gjykues i takon Kryetares, dhe
14 mund të them se duhet ta bëjmë në parashtrim me shkrim këtë e
15 thamë.

16 Ne kemi dhënë njëfarë përvijimi të thuash, të parashtrimeve
17 që do t'i bëjmë në qoftë se do të jetë e nevojshme lidhur me këtë
18 çështje. Ne kemi bërë me shkrim, e kemi thënë me shkrim pra,
19 kornizën e parashtrimeve që do t'i bëjmë në qoftë se del çështja e
20 Trupit Gjykues të përbërë prej një gjykatësi apo tre gjykatësve,
21 dhe këto parashtrime janë në paragrafët 39 deri në 42 të
22 parashtrimeve me shkrim.

23 Dhe, për mendimin tonë, në interes të një organizimi të një
24 gjykimi të drejtë dhe efikas, rregulla 98 kërkon në momentin e
25 transmetimit të çështjes, dorëzimin e dokumenteve që janë një

1 përmbledhje e argumenteve të palëve, të pikave për të cilat palët
2 pajtohen, dhe të materialit provues që kanë paraqitur palët.

3 Mendoj që nuk do të jemi në gjendje që ta bëjmë të gjithë
4 këtë që parashikohet në këtë rregull përpara se të shkëmbejmë jo
5 vetëm dosjet paragjyqësore me Zyrën e Prokurorisë, por edhe të
6 gjitha ato të tjerat që i thashë më lart.

7 Këto janë parashtrimet e mia. Në qoftë se mund t'ju ndihmoj
8 rreth ndonjë pike tjetër që paraqita, atëherë jam i gatshëm ta bëj
9 këtë, veçanërisht lidhur me fushëveprimin e rregullës 72 dhe nenit
10 25(2).

11 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Rees.

12 Urdhëro, z. Cadman.

13 Z. CADMAN: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Faleminderit, i
14 nderuar Gjykatës.

15 Nuk dua të përsëris atë që tha kolegu Rees, po e mbështes
16 propozimin e bërë në emër të z. Gucati dhe Haradinaj.

17 Do të thosha që të -- dua të kem kujdes të mos të futem në
18 çështje që nuk janë diskutuar sot, por shpresojmë që do të merret
19 vendimi lidhur me përbërjen e Trupit Gjykues dhe pastaj do të kemi
20 rastin t'i bëjmë parashtrimet tona përpara Kryetarit përpara se të
21 merret vendimi, për arsyet që i përmendi z. Rees, që kanë rëndësi.

22 E vetmja gjë që doja të them është se është e parakohshme në
23 këtë fazë të marrim atë vendim. Kemi propozuar një Konferencë për
24 Ecurinë e Çështjes në fillim të prillit. Atëherë do të merret dhe
25 vendimi nëse do të ishte me vend që të dërgohej çështja në Trupin

1 Gjykues pavarësisht nga forma.

2 Ne e kemi dëgjuar shpesh termin "proces i përshpejtuar." Kemi
3 njëfarë shqetësimi se duket sikur po bëhet një përpjekje që të
4 shtyhet procesi përpara pa qenë gati, gjë që do të prekte të
5 drejtat e të akuzuarve.

6 Pra, jo vetëm duhen përshpejtuar këto procese, por duhen
7 kryer në mënyrë të drejtë dhe në mënyrë të barabartë midis palëve.
8 Pra, sepse nuk është qëllimi që të paraqitet një -- të zhvillohet
9 një gjyq përpara Gjykatës, por të jetë, siç thashë, i drejtë.

10 Prandaj, qëndrimi im është se do të ishte e parakohshme që të
11 paraqitej kjo çështje në prill pa u zgjidhur problemi i Trupit
12 Gjykues.

13 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Disa gjëra lidhur me kuadrin
14 ligjor.

15 Pika e parë, rregulla 72(1) përmend konkretisht në fund të
16 paragrafit se është pavarësisht nga rregulla 98(1) pra, është një
17 përjashtim.

18 Gjëja e dytë është sesi sistemi, të themi, funksionon. Sipas
19 rregullës 98(3), si Gjykatës i Procedurës Paraprake i jep njoftim
20 Kryetarit dhe këtu fillon kompetenca e Kryetarit. Sipas nenit
21 25(2) fillojmë pra, për të caktuar Trupin Gjykues. Dhe aty mbaron
22 e drejta ime, nuk kam më të drejtë. Pra, ky është kuadri ligjor.

23 Ka ndonjë gjë që doni të shtoni znj. Prokurore?

24 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Jo, i nderuar Gjykatës.

25 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Nuk shoh ndonjë dorë të

1 ngritur.

2 Në këtë çast kërkoj nga palët nëse -- i pyes palët nëse kanë
3 ndonjë çështje tjetër për të ngritur?

4 Dhe si gjithnjë u kërkoj palëve të japin njoftim paraprak
5 nëse ndonjë nga parashtrimet e tyre mund të kërkonin -- përbëjnë
6 informacion konfidencial dhe kërkojnë hyrjen në seancë të mbyllur
7 apo private.

8 Znj. Prokurore.

9 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Jo, ne s'kemi gjë.

10 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, znj. Prokurore.

11 Z. Rees.

12 Z. REES: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Vetëm këtë kam.

13 Në paragrafin 46 të parashtrimeve tona me shkrim - sepse me
14 sa kuptuam ne, Gjykata pyeti se kur mund të zhvillohej gjyqi - ne
15 kemi bërë një propozim lidhur me afatin dhe i kërkojmë Gjykatës ta
16 marrë në shqyrtim.

17 Duke marrë parasysh punën në vazhdim të ZPS-së, kur u duhen
18 dhe gjashtë javë të tjera për të dorëzuar dosjen paragjyqësore,
19 çështjet e vazhdueshme të nxjerrjes së materialeve, përgatitjes të
20 vetë Mbrojtjes, dhe sigurisht duke mbajtur parasysh periudhën e
21 pushimeve që do të zërë muajin gusht.

22 Kemi propozuar pra, që gjyqi të mos zhvillohet përpara 30
23 gushtit 2021. Kjo çështje, me sa kuptojmë, sigurisht mund të
24 diskutohet më tej në Konferencën e ardhshme për Ecurinë e
25 Çështjes. Desha vetëm të ngrija faktin që kemi kërkuar -- i jemi

1 përgjigjur kërkesës për parashtrime për këtë pikë.

2 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Rees.

3 Z. Cadman, të lutem.

4 Z. CADMAN: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Edhe njëherë, i
5 nderuar Gjykatës, dua të konfirmoj se Mbrojtja -- në përputhje me
6 të njëjtin propozim, sepse është një propozim i përbashkët, për të
7 caktuar një afat kohor realist për fillimin e gjykimit.

8 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

9 Faleminderit palëve për parashtrimet e tyre.

10 Tani do të bëjmë një pushim prej 20 minutash dhe do të
11 rifillojmë përsëri afërsisht në orën 13.05 me kohën e Hagës. Dua
12 të lëshoj disa urdhra kur të kthehemi përsëri në seancë.

13 Tani e ndërpresim seancën.

14 --- Pauza fillon në orën 12.46

15 --- Rifillon në orën 13.05

16 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Pasi dëgjuam palët për
17 kalendarin që propozojnë, do të lëshoj tre urdhra:

18 Së pari, deri më 9 prill 2021, palët duhet të më njoftojnë
19 për çdo parashtrim lidhur me marrëveshje për çështjet e ligjit dhe
20 të faktit;

21 Së dyti, deri më 9 prill 2021, ZPS-ja urdhërohet të
22 parashtrojë dosjen e saj, listën e dëshmitarëve dhe të provave, si
23 edhe tabelës në bazë të rregullës 109(c) që do t'ia vërë në dijeni
24 Mbrojtjes;

25 Më 9 prill 2021, ZPS-ja urdhërohet të përfundojë nxjerrjen e

1 materialeve sipas rregullës 102 dhe të përfundojë nxjerrjen e
2 materialeve sipas rregullës 103 që ka në zotërim.

3 Tani u kërkoj palëve të shprehin mendimet e tyre lidhur me
4 datën e përshtatshme për Konferencën tjetër të radhës për Ecurinë
5 e Çështjes, për të diskutuar hapat e mëtejshme dhe kalimin e
6 dosjes para Trupit Gjykues.

7 Keni parasysh edhe Pashkët kur të propozoni datën, ju lutem.

8 Znj. Prokurore, keni fjalën.

9 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] ZPS-ja do të ishte e disponueshme në
10 çdo moment që t'i përshtatet Gjykatës, dhe ne do të ishim në favor
11 të përcaktimit të datës në gjysmën e dytë të marsit për
12 konferencën e ardhshme.

13 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

14 Z. Rees, ju lutem.

15 Z. REES: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Në parashtrimet tona
16 me shkrim kemi propozuar javën pas Pashkëve.

17 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

18 Z. Cadman, ju lutem.

19 Z. CADMAN: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Faleminderit.

20 Ne kemi kërkuar të njëjtën, sepse unë dhe z. Buckley kemi një
21 çështje tjetër në dy javët e para të marsit dhe nuk do të jemi të
22 disponueshëm për këtë çështje. Kështu që pas Pashkëve do të ishte
23 dhe për ne afati më i mirë.

24 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Cadman.

25 Do të merrni urdhrat përkatëse që do t'i përfshijmë përpara

1 konferencës.

2 I ftoj palët të bëjnë parashtime me shkrim në qoftë se
3 dëshirojnë të ngrenë ndonjë çështje konkrete përpara konferencës
4 së ardhshme.

5 Këtu përfundon seanca e sotshme. Falënderoj palët dhe të
6 gjithë të tjetër të pranishëm, stenografët, teknikët, personelin e
7 sigurisë.

8 Seanca merr fund këtu.

9 --- Konferenca për Ecurinë e Çështjes përfundoi në orën 13.08

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25